



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“AMERICAN TV OF KOSOVA” SH.P.K.

Numri i biznesit - 810179160

Pronar: Xhelal TETAJ dhe Mhill GJURAJ

OSHMA “AMERICAN TV OF KOSOVA”

Rr/Bajram Kelmendi

Pejë

Ref:1901/116/LIC/ni

## VENDIM

për licencimin e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Adiovizuale (OSHMA) “AMERICAN TV OF KOSOVA” për transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes – me seli në Pejë

---

### Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2017/02, ka hyrë në fuqi më 25 janar 2017, ndërsa, me Kreun III të kësaj rregulloreje, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes, e që do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore dhe t'i transmetojnë ato përmes cilit do operatorë të shpërndarjes.
3. Më datën 30 janar 2019, kandidati “AMERICAN TV OF KOSOVA”, ka parashtruar aplikacionin për licencë të KPM-së për të vepruar si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) për transmetim të programeve me karakter gjeneralistik, përmes operatorit të shpërndarjes.


### Arsyetim

4. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së OSHMA “AMERICAN TV OF KOSOVA”, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhënat e nevojshme për Licencë të KPM-së dhe në pajtueshmëri me Kreun III të Rregullores KPM-2017/02.

5. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së “AMERICAN TV OF KOSOVA” ka ofruar të dhënat e mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Materialet e ofruara si pjesë e aplikacionit konsiderohen të qëndrueshme sa i përket skemës programore në përgjithësi; të dhënat rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve medilae audiovizuale, përfshirë edhe të dhënat rreth qëndrueshmërisë financiare.
6. Sipas Nenit 21, paragrafit 5 të Rregullores KPM-2017/02, kandidati për licencë të KPM-së “AMERICAN TV OF KOSOVA”, duhet të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
7. Komisioni vlerëson se, kandidati “AMERICAN TV OF KOSOVA” ka përmbushur kriteret kualifikuese për t’u pajisur me licencë të KPM-së për ofrues të shërbimeve mediale audivizuale, në pajtim të plotë me Rregulloren e KPM-së KPM-2017/02.

### VENDIM

8. Komisioni në takimin e tij, të mbajtur më datën 31 janar 2019, merr vendim që, kandidatit “AMERICAN TV OF KOSOVA”, me seli në Pejë, t’i lëshoj licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
9. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.

  
\_\_\_\_\_  
Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



31.01.2019

datë